



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sports

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MKRS) NR. 01/2022 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT
E THEMELIMIT, LICENCIMIT DHE RI-VLERËSIMIT TË FEDERATAVE DHE ORGANIZATAVE
SPORTIVE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MKRS) NO. 01/2022 ON THE TERMS, CRITERIA AND
PROCEDURES FOR THE ESTABLISHMENT, LICENSING AND RE-EVALUATION OF SPORTS
FEDERATIONS AND ORGANIZATIONS**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MKOS) BR. 01/2022 O USLOVIMA, KRITERIJUMIMA I
PROCEDURAMA ZA OSNIVANJE, LICENCIRANJE I PONOVDNU EVALUACIJU SPORTSKIH
FEDERACIJA I ORGANIZACIJA**

<p>Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,</p> <p>Në mbështetje të neneve 31 dhe 32 të Ligjit për Sport Nr. 2003/24, (Gazeta Zyrtare Nr. 22/2008, 01.03.2008), nenit 8, nënparagrafi 1.4, të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare 30.03.2021), si dhe nenin 38, paragrafi 6, të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 15/12, shtator 2011),</p> <p>Nxjerrë:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MKRS) NR. 01/2022 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E THEMELIMIT, LICENCIMIT DHE RI-VLERËSIMIT TË FEDERATAVE DHE ORGANIZATAVE SPORTIVE</p>	<p>Minister of the Ministry of Culture Youth and Sports,</p> <p>Pursuant to Articles 31 and 32 of Law on Sports No. 2003/ 24, (Official Gazette No. 22/2008, 01.03.2008), Article 8, subparagraph 1.4, of Regulation No. 02/2021 on Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, as well as Article 2021, paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011 of the Government of the Republic of Kosovo (Official Gazette No. 15/12, September 2011),</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MCYS) NO. 01/2022 ON CONDITIONS, CRITERIA AND PROCEDURES FOR ESTABLISHMENT, LICENSING AND RE-EVALUATION OF SPORTS FEDERATIONS AND ORGANIZATIONS</p>	<p>Ministar Ministarstva kulture, omladine i sporta,</p> <p>Na osnovu člana 31. i 32. Zakona o sportu br. 2003/24, (Službeni list br. 22/2008, 01.03.2008), člana 8, podstav 1.4, Uredbe br. 02/2021 o Oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava (Službeni list 30.03.2021.), kao i člana 38. stav 6. Uredbe br. 09/2011 Pravilnika o radu Vlade Republike Kosovo (Službeni list br. 15/12, septembar 2011),</p> <p>Donosi:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MKOS) BR. 01/2022 O USLOVIMA, KRITERIJUMIMA I PROCEDURAMA ZA OSNIVANJE, LICENCIRANJE I PONOVNU EVALUACIJU SPORTSKIH FEDERACIJA I ORGANIZACIJA</p>
--	---	---

<p align="center">KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p>	<p align="center">CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p>	<p align="center">POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p>
<p align="center">Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet, kriteret, procedurat e aplikimit si dhe organet kompetente për themelimin dhe organizimin e procesit të licencimit të federatave sportive nga Ministria përkatëse për Sport duke respektuar strukturën, të drejtat dhe obligimet që janë përcaktuar me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për rregullimin e veprimtarisë sportive në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet edhe procedura e veçantë e ri vlerësimit të licencimit, pezullimit apo revokimit të parakohshëm të licencës si dhe e drejta në ushtrimin e mjeteve juridike në rastet e parashikuara me këtë Udhëzim Administrativ.</p>	<p align="center">Article 1 Purpose</p> <p>1. The present Administrative Instruction shall define the conditions, criteria, application procedures and competent bodies for the establishment and organization of the licensing process of Sports Federations by the relevant Ministry of Sports, complying with the structure, rights and obligations set out in the applicable laws and regulations for regulation of sports activity in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The present Administrative Instruction shall also regulate the special procedure of re-evaluation of licensing, suspension or early revocation of the license, as well as the right to exercise legal remedies in the cases provided for by this Administrative Instruction.</p>	<p align="center">Član 1 Svrha</p> <p>1. Ovo Administrativno uputstvo definiše uslove, kriterijume, procedure za apliciranje kao i nadležne organe za osnivanje i organizovanje procesa licenciranja sportskih federacija od strane nadležnog Ministarstva za sport, poštujući strukturu, prava i obaveze utvrđene važećim zakonima i podzakonskim aktima za regulisanje sportske delatnosti u Republici Kosovo.</p> <p>2. Ovim administrativnim uputstvom se takođe uređuje poseban postupak za ponovnu procenu licenciranja, obustave ili prevremenog oduzimanja licence, kao i pravo na korišćenje pravnih lekova u slučajevima predviđenim ovim Administrativnim uputstvom.</p>
<p align="center">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij Udhëzimi janë të detyrueshme për të gjithë personat</p>	<p align="center">Article 2 Scope</p> <p>Provisions of the present Instruction shall be mandatory to all responsible persons of</p>	<p align="center">Član 2 Delokrug</p> <p>Odredbe ovog uputstva su obavezne za sva odgovorna lica sportskih federacija i</p>

<p>përgjegjës të federatave dhe organizatave sportive si dhe personat zyrtarë të Ministrisë për Sport, të cilët kanë të drejta dhe detyrime ligjore në zbatimin e procesit të themelimit, licencimit, ri-vlerësimit dhe revokimit të licencës në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës përfshirë dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Komisioni për vlerësimin e kriterëve për licencimin e Federatave sportive - nënkupton organin kolegjal të themeluar me Vendim të Ministrit i cili bënë shqyrtimin e kërkesave të federatave sportive dhe i njëjti i rekomandon Ministrit lëshimin, refuzimin apo revokimin e licencës në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ;</p> <p>1.2. Ministri – nënkupton ministrin përkatës në fushën e sportit;</p>	<p>Sports Federations and organizations as well as the Ministry of Sports officials, having legal rights and obligations in the implementation of the process of establishment, licensing, re-evaluation and revocation of the license in accordance with the provisions of sports legislation including the provisions of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Expressions used in this Administrative Instruction shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Commission for evaluation of criteria for licensing of Sports Federations - shall mean a collegial body established by the Minister's Decision that examines the applications of Sports Federations and the same recommends to the Minister the issuance, refusal or revocation of the license in accordance with the provisions set out in the present Administrative Instruction;</p> <p>1.2. Ministries - shall mean the relevant minister in the area of sports;</p>	<p>organizacija kao i službena lica Ministarstva sporta, koja imaju zakonska prava i obaveze u sprovođenju procesa osnivanja, licenciranja, ponovnu evaluaciju i oduzimanja licence u skladu sa odredbama relevantnog zakonodavstva uključujući i ovo Administrativno uputstvo.</p> <p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Komisija za ocenjivanje kriterijuma za licenciranje sportskih federacija - podrazumeva kolegijalni organ osnovan Odlukom ministra koji razmatra prijave sportskih federacija i isti preporučuje ministru izdavanje, odbijanje ili oduzimanje licence u skladu sa odredbama utvrđenim ovim Administrativnim uputstvom;</p> <p>1.2. Ministar - podrazumeva dotičnog ministra u oblasti sporta;</p>
--	--	---

<p>1.3. MKRS - Ministria përkatëse për sport;</p> <p>1.4. Themelimi – procedura e rregulluar me ligjin përkatës për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare për themelimin dhe regjistrimin në organin publik kompetent të një organizate a shoqate si person juridik si dhe kushtet, kriteret dhe procedurat që shoqata apo organizata – personi juridik duhet të përmbushë për të marrë statusin e federatës sportive, përkatësisht të drejtën e organizimit të një dege të caktuar sportive sikurse është parashikuar me legjislacionin me të cilin rregullohet fusha e sportit në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. Federatë sportive – konsiderohet organizata sportive, si shoqatë qytetare, që themelohet dhe licencohet për qëllime të organizimit, zhvillimit dhe përhapjes së sportit në degë të caktuara sportive, në gjithë territorin e Kosovës;</p> <p>1.6. Organizatë sportive - konsiderohet çdo organizëm që zhvillon veprimtari sportive;</p>	<p>1.3. MKRS - relevant Ministry of Sports;</p> <p>1.4. Establishment - the procedure regulated by the relevant law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations for the establishment and registration with the competent public body of an organization or association as a legal entity as well as the conditions, criteria and procedures that such association or organization - legal entity must satisfy to obtain the status of a sports federation, respectively the right to the organization of a certain sports branch as provided for by the legislation which regulates the area of sports in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. Sports federation - shall be considered a sports organization, as a civic association, which is established and licensed for the purpose of organizing, developing and conducting sports in certain sports branches, throughout the territory of Kosovo;</p> <p>1.6. Sports organization - shall be considered any organism conducting sports activities;</p>	<p>1.3. MKOS - Dotično ministarstvo za sport;</p> <p>1.4. Osnivanje - postupak uređen odgovarajućim Zakonom o slobodi udruživanja u nevladine organizacije za osnivanje i upisa u nadležnom javnom organu organizacije ili udruženja kao pravnog lica, kao i uslovi, kriterijumi i procedure koje udruženje ili organizacija - pravno lice mora da ispunjava za sticanje statusa sportske federacije, odnosno pravo organizovanja određene sportske grane kao što je predviđeno zakonodavstvom s kojom se uređuje oblast sporta u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. Sportska federacija - smatra se sportskom organizacijom, kao udruženje građana, koje se osniva i licencira u cilju organizovanja, razvoja i širenja sporta u određenim sportskim ograncima, na celoj teritoriji Kosova;</p> <p>1.6. Sportska organizacija – smatra se svaki organizam koji obavlja sportske aktivnosti;</p>
---	--	---

<p>1.7. Licenca - nënkupton të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë së federatës bazuar në dokumentin e lëshuar nga organi kompetent i Ministrisë i cili dëshmon se kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, Ligjin përkatës për Sport dhe Ligjin përkatës për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, janë plotësuar;</p> <p>1.8. Ri-vlerësim i licencës – nënkupton procesin nëpër të cilën duhet të kalojnë federatat dhe organizatat sportive të reja të cilat për herë të parë themelohen dhe licencohen pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, ku të njëjtat duhet ti nënshtrihen procesit të vlerësimit pas afatit kohor 1 vjeçar prej kohës kur federata është licencuar për herë të parë;</p> <p>1.9. Regjistri i federatave – nënkupton sistemin e të dhënave të cilin e krijon dhe mirëmban Ministria përkatëse për sport.</p>	<p>1.7. License - means the right to exercise the activity of the federation based on the document issued by the competent body of the Ministry which proves that the conditions and criteria set out in this Administrative Instruction, the relevant Law on Sports and the relevant Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations, are met;</p> <p>1.8. Re-evaluation of the license - shall mean the process new Sports Federations and organizations must go through, which are established and licensed for the first time after the entry into force of the present Administrative Instruction, where they must be subject to the evaluation process after a period of 1 year from the time when a federation is licensed for the first time;</p> <p>1.9. Register of federations - means the data system which is created and maintained by the relevant Ministry of Sports.</p>	<p>1.7. Licenca - podrazumeva pravo obavljanja delatnosti federacije na osnovu dokumenta izdatog od strane nadležnog organa Ministarstva koji dokazuje da su ispunjeni uslovi i kriterijumi utvrđeni ovim Administrativnim uputstvom, relevantnim Zakonom o sportu i relevantnim Zakonom o slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama;</p> <p>1.8. Ponovna procena licence - podrazumeva proces kroz koji moraju da prolaze nove federacije i sportske organizacije, koje se osnivaju i licenciraju po prvi put nakon stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva, gde iste moraju da se podvrgnu procesu procene nakon perioda od 1 godine od trenutka kada je federacija po prvi put licencirana;</p> <p>1.9. Registar i federacija - podrazumeva sistem podataka koji kreira i održava nadležno Ministarstvo sporta.</p>
--	--	--

<p align="center">KAPITULLI II THEMELIMI</p>	<p align="center">CHAPTER II ESTABLISHMENT</p>	<p align="center">POGLAVLJE II OSNIVANJE</p>
<p align="center">E DREJTA E THEMELIT DHE STATUSI LIGJOR I FEDERATËS DHE ORGANIZATËS SPORTIVE</p>	<p align="center">THE RIGHT OF ESTABLISHMENT AND THE LEGAL STATUS OF THE FEDERATION AND SPORTS ORGANIZATION</p>	<p align="center">PRAVO NA OSNIVANJE I PRAVNI STATUS FEDERACIJA I SPORTSKE ORGANIZACIJE</p>
<p align="center">Neni 4 E drejta e themelimit</p>	<p align="center">Article 4 The right of establishment</p>	<p align="center">Član 4 Pravo na osnivanje</p>
<p>1. Çdo person ka të drejtën e themelimit të një Federate nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin përkatës për Sport, Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare si dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.</p> <p>2. Federatat sportive themelohen për arritjen e qëllimeve të organizimit të veprimtarisë në një degë të caktuar sportive në nivel shtetëror dhe përfaqësimin e sportit të caktuar në nivel ndërkombëtar, përcaktimin dhe realizimin e objektivave dhe aktiviteteve zhvillimore në degë të caktuar sportive, organizimin apo udhëheqjen e grave sportive apo aktiviteteve rekreative dhe promovuese, si dhe përcaktimin e lirë të anëtarëve për të kontribuar në arritjen e objektivave të</p>	<p>1. Every person shall have the right to establish a Federation if they meet the conditions and criteria set out in the relevant Law on Sports, the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations and the conditions and criteria set out in this Administrative Instruction.</p> <p>2. Sports Federations shall be established to achieve the goals of organizing the activity in a certain sports branch at the state level and representing certain sports at the international level, defining and achieving development goals and activities in certain sports branches, organizing or leading sports competitions or recreational and promotional activities, as well as the free determination of members to contribute to the achievement of the goals of public sport policy as an area of public interest defined by law.</p>	<p>1. Svako lice ima pravo da osnuje federaciju ako ispunjava uslove i kriterijume propisane relevantnim Zakonom o sportu, Zakonom o slobodi udruživanja u nevladine organizacije i uslove i kriterijume utvrđene ovim Administrativnim uputstvom.</p> <p>2. Sportske federacije se osnivaju radi ostvarivanja ciljeva organizovanja delatnosti u određenoj sportskoj grani na nivou države i predstavljanja pojedinih sportova na međunarodnom nivou, definisanja i ostvarivanja razvojnih ciljeva i aktivnosti u određenim sportskim granama, organizovanja ili vođenja sportskih takmičenja ili rekreativnih i promotivne aktivnosti, kao i slobodno opredeljenje članova da doprinesu ostvarivanju ciljeva javne sportske politike</p>

<p>politikës publike të sportit si fushë e interesit publik e përcaktuar me ligj.</p> <p>3. Federatat, bazuar në rregullat e organizatave ndërkombëtare sportive ku ato janë anëtare dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, përcaktojnë në mënyrë të pavarur sistemin e konkurrencës në sport për të cilën janë themeluar dhe angazhohen në nxitjen dhe masovizimin e sportit në përputhje me dokumentet përkatëse strategjike të zhvillimit të sportit në Kosovë dhe aktet e saj, organizon kampionate sportive si dhe kujdeset për mirëqenien dhe shëndetin e sportistëve në përgjithësi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Statusi Ligjor</p> <p>1. Federatat sportive janë entitete të organizuara mbi bazën e vullnetit të lirë të anëtarëve të tyre, të cilat subjektivitetin e tyre juridik e fitojnë me rastin e regjistrimit në organin kompetent për zbatimin e ligjit në fuqi për lirinë e asociimit si dhe në momentin e licencimit të tyre në MKRS, nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin në fuqi për Sport, si dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.</p>	<p>3. The federations, based on the rules of the international sports organizations where they are members and in accordance with the legislation in force, independently determine the system of competition in sports for which they are established and engage in the promotion and popularization of sports in accordance with the strategic documents of sports development in Kosovo and its acts, organizes sports championships and takes care of the well-being and health of athletes in general.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Legal status</p> <p>1. Sports Federations shall be entities organized based on the free will of their members, which acquire their legal subjectivity upon registration with the competent body for the implementation of the law in force on freedom of association and at the time of registration and licensing at MCYS they have fulfilled the conditions and criteria set out in the applicable Law on Sports, as well as the conditions and criteria set out in this Administrative Instruction.</p>	<p>kao oblasti od javnog interesa definisane zakonom.</p> <p>3. Federacije, na osnovu pravila međunarodnih sportskih organizacija čiji su članovi i u skladu sa važećim zakonodavstvom, samostalno utvrđuju sistem konkurentnosti u sportovima za koje su osnovani i bave se unapređenjem i masovizacije sporta u skladu sa relevantnim strateškim dokumenta i svojim aktima o razvoju sporta na Kosovu, organizuje sportska prvenstva i brine o dobrobiti i zdravlju sportista uopšte.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Pravni status</p> <p>1. Sportske federacije su subjekti organizovani na osnovu slobodne volje svojih članova, koji svoj pravni subjektivitet stiču upisom kod nadležnog organa za sprovođenje zakona o slobodi udruživanja na snazi kao i u trenutku njihove upisa licenciranja u MKOS-u, ako ispunjava uslove i kriterijume utvrđene važećim Zakonom o sportu, kao i uslove i kriterijume utvrđene ovim Administrativnim uputstvom.</p>
---	--	---

<p>2. Përveç rasteve kur ndryshe është përcaktuar me ligjet dhe aktet e tjera juridike në fuqi, entitetet e përcaktuara në paragrafin paraprak funksionojnë si të pavarura dhe nuk i nënshtrohen ndikimeve politike, religjioze apo ndonjë mase tjetër ekzekutive apo administruese të autoriteteve publike për çështjet që me dispozita ligjore u është garantuar ushtrim i lirë dhe i pavarur i funksioneve. Federata apo organizata sportive ka strukturën përkatëse të menaxhimit dhe politikat zhvillimore të federatës/organizatës si dhe aktivitetet e saj i zhvillon në përputhje me dokumentet përkatëse strategjike të zhvillimit të sportit në Kosovë dhe në përputhje me politikat dhe aktet juridike në fuqi.</p> <p>3. Pavarësisht paragrafit një (1) dhe dy (2) të këtij neni, federatat sportive, në përputhje me qëllimet e themelimit të tyre dhe brenda autorizimeve të fituara me ligjet e Republikës së Kosovës si dhe me aktet e organizatave sportive ndërkombëtare, janë të obliguara të sigurojnë respektimin e ligjit mbi bazën e të cilit e kanë fituar subjektivitetin juridik dhe legjislacionin mbi bazën e të cilit marrin autorizimin/licencën për organizimin e degës përkatëse sportive.</p>	<p>2. Unless otherwise provided by applicable laws and other legal acts, the entities defined in the preceding paragraph shall operate as independent and shall not be subject to political, religious or other executive or administrative influence of the public authorities on matters related to the free and independent exercise of functions warranted by law. The sports federation or organization shall have a relevant management structure and development policies of the federation/organization and shall conduct its activities in accordance with the relevant strategic documents for the development of sports in Kosovo and in accordance with applicable policies and legal acts.</p> <p>3. Notwithstanding paragraphs one (1) and two (2) of this Article, sports federations shall, in accordance with the purposes of their establishment and within the authorizations obtained under the laws of the Republic of Kosovo and the acts of international sports organizations, be obliged to ensure compliance with the law based on which they have acquired legal subjectivity and the legislation based on which they obtain the authorization/license for organizing the respective sports branch.</p>	<p>2. Osim u slučajevima ako važećim zakonima i drugim pravnim aktima nije drugačije određeno, subjekti definisani u prethodnom stavu funkcionišu kao nezavisni i neće biti podvrgnuti političkom, verskom ili drugom izvršnom ili administrativnom uticaju organa javne vlasti za pitanja kojima se zakonskim odredbama garantuje slobodno i nezavisno vršenje funkcija. Sportska federacija ili organizacija ima odgovarajuću strukturu upravljanja i razvojne politike federacije/organizacije i sprovodi svoje aktivnosti u skladu sa relevantnim strateškim dokumentima za razvoj sporta na Kosovu i u skladu sa važećim politikama i zakonskim aktima.</p> <p>3. Izuzev od stava jedan (1) i dva (2) ovog člana, sportske federacije, u skladu sa svrhom njihovog osnivanja i u okviru ovlašćenja dobijenih na osnovu zakona Republike Kosovo i akta međunarodnih sportskih organizacija, dužni su da obezbede poštovanje zakona na osnovu kojeg su stekli pravni subjektivitet i zakonodavstva na osnovu kojeg dobijaju ovlašćenje/licencu za organizovanje odgovarajuće sportske grane.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 6 Transparenca</p> <p>Federata sportive apo organizata sportive vepron me përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe me transparencë në të gjitha fazat e veprimtarisë së saj në përputhje me Ligjin përkatës për qasje në dokumente publike dhe Ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI III PARIMET DHE KRITERET THEMELORE PËR LICENCIM</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Parimet e licencimit të federatave</p> <p>1. Licencimi i federatave organizohet, përktatësisht zhvillohet duke u bazuar në parimet e ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe krijimit të mjedisit të përshtatshëm për zhvillimin dhe avancimin e veprimtarisë së caktuar sportive si dhe përdorimin e bashkërendimin e burimeve dhe resurseve publike dhe jo publike në funksion të avancimit të sportit si interes i rëndësishëm publik në përputhje me legjislacionin përkatës për fushën e sportit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Transparency</p> <p>Sports federation or sports organization shall act with responsibility, accountability and transparency in all phases of its activity in accordance with the relevant Law on Access to Public Documents and the relevant Law on Personal Data Protection.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III BASIC PRINCIPLES AND CRITERIA FOR LICENSING</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Licensing principles of federations</p> <p>1. Licensing of Sports Federations shall be organized, respectively conducted, based on the principles of legality, transparency, accountability and creation of a suitable environment for the development and advancement of certain sports activity as well as the use and coordination of public and non-public resources in order to advance sport as an important public interest in accordance with the relevant legislation in the field of sports.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Transparentnost</p> <p>Sportska federacija ili sportska organizacija u svim fazama svog delovanja postupa odgovorno, savesno i transparentno u skladu sa relevantnim Zakonom o pristupu javnim dokumentima i relevantnim Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III OSNOVNA NAČELA I KRITERIJUMI ZA LICENCIRANJE</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Načela licenciranja federacija</p> <p>1. Licenciranje federacija je organizovano, odnosno razvijeno na principima zakonitosti, transparentnosti, odgovornosti i stvaranja pogodnog ambijenta za razvoj i unapređenje određene sportske aktivnosti, kao i korišćenje i koordinaciju javnih i nejavnih resursa u funkciju unapređenja sporta kao značajnog javnog interesa u skladu sa relevantnom zakonodavstvom u oblasti sporta.</p>
--	--	--

<p>2. Licencimi i federatave bazohet gjithashtu në parimin e respektimit të autonomisë funksionale, lirisë së asociimit dhe të drejtës për grumbullim vullnetar të anëtarëve të federatës si dhe në respektimin e mandatit ligjor të Ministrisë për sa i përket përgjegjësiwe rregullatore dhe zbatimit të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ dhe legjislacionin përkatës për fushën e sportit.</p>	<p>2. Licensing of federations shall also be based on the principle of respecting functional autonomy, freedom of association and the right to voluntary assembly of federation members as well complying with the legal mandate of the Ministry regarding the regulatory responsibilities and implementation of the conditions and criteria set out in this Administrative Instruction and the relevant legislation in the field of sports.</p>	<p>2. Licenciranje federacija je takođe zasnovano na principu poštovanja funkcionalne autonomije, slobode udruživanja i prava na dobrovoljno okupljanje članova federacije, kao i poštovanja zakonskog mandata Ministarstva u pogledu regulatorne odgovornosti i sprovođenje uslova i kriterijuma utvrđenih ovim Administrativnim uputstvom i relevantnim zakonima u oblasti sporta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Autoriteti licencues</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Licensing authority</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Autoritet licenciranja</p>
<p>1. Ministria përkatëse për Sport është autoriteti i vetëm licencues i federatës apo organizatës sportive.</p> <p>2. E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë lind pasi subjekti të jetë pajisur me licencë nga Ministria në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Udhëzimi Administrativ.</p>	<p>1. The relevant Ministry of Sports is the sole licensing authority of the federation or sports organization.</p> <p>2. The right to start exercising the activity arises after the entity has been provided with a license by the Ministry in accordance with the relevant provisions of the present Administrative Instruction.</p>	<p>1. Nadležno Ministarstvo sporta je jedini organ za izdavanje licence federaciji ili sportskoj organizaciji.</p> <p>2. Pravo na početak vršenja delatnosti nastaje nakon što subjekat dobije licencu od strane Ministarstva u skladu sa relevantnim odredbama ovog Administrativnog uputstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Kushtet dhe kriteret për licencim</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Conditions and criteria for licensing</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Uslovi i kriterijumi licenciranja</p>
<p>1. Federatat sportive mund të licencohen, përkatësisht të fitojnë cilësinë e federatës</p>	<p>1. Sports federations can be licensed, respectively to acquire the status of a</p>	<p>1. Sportske federacije mogu biti licencirani, odnosno da steknu svojstvo</p>

<p>sportive me plotësimin e kushteve dhe kriterëve të cilat janë:</p> <p>1.1. Kushtet dhe kriteret e përgjithshme;</p> <p>1.2. Kushtet dhe kriteret specifike.</p>	<p>sports federation by meeting the following conditions and criteria:</p> <p>1.1. General conditions and criteria;</p> <p>1.2. Specific conditions and criteria.</p>	<p>sportske federacije ispunjavanjem uslova i kriterijuma koji su:</p> <p>1.1. Opšti uslovi i kriterijumi;</p> <p>1.2. Specifični uslovi i kriterijumi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Kushtet dhe Kriteret e Përgjithshme</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 General Conditions and Criteria</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Opšti kriterijumi za licenciranje</p>
<p>1. Kushtet dhe kriteret e përgjithshme për licencimin e federatave sportive janë:</p> <p>1.1. Kriteret e themelimit përkatësisht kërkesat që lidhen me statusin e personit juridik të federatës të cilat derivojnë nga Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare;</p> <p>1.2. Kriteret ligjore përkatësisht kërkesat që derivojnë nga Ligji përkatës për Sport dhe nga ky Udhëzim Administrativ;</p> <p>1.3. Kriteret e krijimit të rregullativës ligjore të federatës në përputhje me ligjet në fuqi që rregullojnë fushën e sportit në Republikën e Kosovës, si dhe të përshtatura me aktet juridike të organizatave ndërkombëtare ku</p>	<p>1. The general conditions and criteria for licensing sports federations are as follows:</p> <p>1.1. Establishment criteria or requirements related to the status of the legal entity of the federation which derive from the Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations;</p> <p>1.2. Legal criteria, respectively requirements deriving from the relevant Law on Sports and this Administrative Instruction;</p> <p>1.3. Criteria for the creation of legal regulations of the federation in accordance with applicable laws governing the field of sports in the Republic of Kosovo, as well as adapted to the legal acts of international</p>	<p>1. Opšti uslovi i kriterijumi za licenciranje sportskih federacija su:</p> <p>1.1. Kriterijumi za osnivanje, odnosno uslovi koji se odnose na status pravnog lica federacije koji proizilaze iz Zakona o slobodi udruživanja u nevladine organizacije;</p> <p>1.2. Pravni kriterijumi, odnosno zahtevi koji proizilaze iz relevantnog Zakona o sportu i ovog Administrativnog uputstva;</p> <p>1.3. Kriterijumi za kreiranje zakonske regulative federacije u skladu sa zakonima na snazi koji regulišu oblast sporta u Republici Kosovo, kao i prilagođeni pravnim aktima međunarodnih organizacija u kojima je</p>

<p>federata apo organizata sportive është anëtare gjithnjë duke pasur parasysh nivelin e zhvillimit të kapaciteteve infrastrukturore të saj;</p> <p>1.4. Kriteret financiare bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. Kriteret e qeverisjes së mirë, funksionimit dhe zbatimit të rregullativës ligjore përfshirë transparencën, mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të anëtarësisë dhe sportistëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Kushtet dhe Kriteret Specifike për Licencim</p> <p>1. Federata për tu licencuar në Ministrinë përkatëse për Sport, duhet të përmbush kushtet dhe kriteret specifike si në vijim:</p> <p>1.1. Të jetë e themeluar në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare;</p>	<p>organizations where the federation or sports organization is a member, always taking into account the level of development of its infrastructural capacities;</p> <p>1.4. Financial criteria based on the relevant legislation in force in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. Criteria for good governance, functioning and implementation of legal regulations including transparency, mechanisms for protection of the rights of membership and athletes.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Specific Conditions and Criteria for Licensing</p> <p>1. In order for a Federation to be licensed in the relevant Ministry of Sports, must meet the specific conditions and criteria as follows:</p> <p>1.1. To be established in accordance with the provisions of the relevant law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations;</p>	<p>federacija ili sportska organizacija član uvek uzimajući u obzir stepen razvijenosti kapaciteta svoje infrastrukturne;</p> <p>1.4. Finansijski kriterijumi na osnovu relevantnog zakonodavstva na snazi u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. Kriterijumi dobrog upravljanja, funkcionisanje i sprovođenje zakonske regulative uključujući transparentnost, mehanizme zaštite članskih prava i sportista.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Posebni uslovi i kriterijumi za licenciranje</p> <p>1. Da bi dobili licencu u nadležnom Ministarstvu sporta, Federacija mora ispuniti sledeće specifične uslove i kriterijume:</p> <p>1.1. Mora biti osnovana u skladu sa odredbama relevantnog zakona o Slobodi udruživanja u nevladine organizacije;</p>
---	---	--

<p>1.2. Marrëveshjen e së paku pesë (5) klube sportive aktive në fushën e njejtë të caktuar sportive, ku së paku tre (3) prej tyre janë themeluar dhe funksionojnë së paku për dy vite para aplikimit për licencim për herë të parë;</p> <p>1.3. Të ketë hartuar dhe miratuar aktet juridike të përcaktuara në nenin 13 dhe të njëjtat të jenë harmonizuar me dispozitat e këtij Udhëzimi Adiministrativ, Ligjit përkatës për Sport, Ligjit përkatës për Lirinë e Asociimit në Oganizata Joqeveritare dhe me aktet ndërkombëtare të Federatës ku ajo është anëtare;</p> <p>1.4. Të ketë infrastrukturë optimale për ushtrimin e veprimtarisë së Federtës dhe klubeve sportive;</p> <p>1.5. Të ketë anëtarësinë e saj gjithëpërfshirëse si në aspektin gjinor dhe të ofroj ambient të mirë për përfshirjen e komuniteteve të cilat njihen me Kushtetutë dhe legjislacionin përkatës;</p> <p>1.6. Të ketë dëshmi për numrin e sportistëve, trajnerëve, gjyqtarëve, personave të përfshirë në Federatë dhe të anëtarësisë së saj.</p>	<p>1.2. The agreement of at least five (5) sports clubs active in the same designated sports field, where at least three (3) of them are established and operate for at least two years before applying for a license for the first time;</p> <p>1.3. To have drafted and approved the legal acts defined in Article 13 and the same to be harmonized with the provisions of this Administrative Instruction, the relevant Law on Sports, the relevant Law on Freedom of Association in Non-Governmental Organizations and international acts of the Federation where it is a member;</p> <p>1.4. To have optimal infrastructure for the exercise of the activity of the Federation and sports clubs;</p> <p>1.5. To have its comprehensive membership both in terms of gender and to provide a good environment for the inclusion of communities which are familiar with the Constitution and relevant legislation;</p> <p>1.6. Have evidence of the number of athletes, coaches, judges, persons involved in the Federation and its membership.</p>	<p>1.2. Ugovor o najmanje pet (5) sportskih klubova aktivnih na istom određenom sportskoj oblasti, pri čemu su najmanje tri (3) od njih osnovana i deluju najmanje dve godine pre prvog podnošenja aplikacije za licencu;</p> <p>1.3. Da ima izrađene i usvojene zakonske akte definisane članom 13 i isti da budu usklađeni sa odredbama ovog Administrativnog uputstva, relevantnog Zakona o sportu, relevantnog Zakona o Slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama i sa međunarodnim aktima Federacije čiji je član;</p> <p>1.4. Da ima optimalnu infrastrukturu za obavljanje delatnosti Federacije i sportskih klubova;</p> <p>1.5. Da ima svoje sveobuhvatno članstvo i u pogledu pola i da obezbedi dobro okruženje za uključivanje zajednica koje su priznate Ustavom i relevantnim zakonodavstvom;</p> <p>1.6. Imati sertifikat o broju sportista, trenera, sudija, lica uključenih u Federaciji i njegovog članstva.</p>
--	---	--

<p>2. Federatat sportive nxisin dhe promovojnë vlerat sportive, konkurrencën e lirë sportive dhe respektimin e lirisë së ushtrimit të veprimtarisë si dhe ligjshmërinë si vlerë kushtetuese e Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Federatat sportive sigurojnë përfaqësim të bazuar në rregullat e brendshme për organizimin dhe funksionimin e një subjekti joqeveritar sikurse përcaktohet me Ligjin për Lirinë e Asociimit, përkatësisht të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.</p> <p>4. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, asnjë federatë nuk do të licencohet në rastet kur në organet drejtuese të tyre përgjegjësitë i ushtrojnë personat e dënuar me vendim të formës së prerë në ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në Kapitullin XXXIII të Kodit Penal të cilat ndërlidhen me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.</p> <p>5. Federatave/Organizatave sportive ju pushon vlefshmëria e licencës në rastet kur konstatohet se personat që janë bartës të funksioneve në organet drejtuese, janë gjithashtu anëtarë të subjekteve të cilat merren me organizimin e basteve sportive së paku tre vitet e fundit.</p>	<p>2. Sports federations shall promote and stimulate sports values, free sports competition and respect for the freedom to exercise activity and legality as a constitutional value of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Sports federations shall provide representation based on the internal rules for the organization and functioning of a non-governmental entity as defined by the Law on Freedom of Association, respectively the right to vote and to be elected.</p> <p>4. Notwithstanding the above paragraph, no federation shall be licensed in cases where in its governing bodies the responsibilities are exercised by persons convicted by a final decision in any of the criminal offenses set forth in Chapter XXXIII of the Criminal Code which relate with official corruption and criminal offenses against official duty.</p> <p>5. Federations/Sports Organizations are terminated the validity of the license in cases when it is ascertained that the persons who hold positions in the governing bodies, are also members of the entities that deal with the organization of sports betting for at least the last three years.</p>	<p>2. Sportske federacije podstiču i promovišu sportske vrednosti, slobodno sportsko takmičenje i poštovanje slobode delovanja i zakonitosti kao ustavne vrednosti Republike Kosovo.</p> <p>3. Sportske federacije obezbeđuju zastupanje na osnovu internih pravila za organizaciju i funkcionisanje nevladinog subjekta definisanog Zakonom o slobodi udruživanja, odnosno pravo da biraju i da budu birani.</p> <p>4. Bez obzira na prethodni stav; nijedna federacija neće biti licencirana u slučajevima kada u njihovim organima upravljanja odgovornosti vrše lica koja su pravosnažnom presudom osuđena za neko od krivičnih dela definisanih u glavi XXXIII Krivičnog zakonika koja se odnose na korupciju u službenoj dužnosti i krivična dela protiv službene dužnosti.</p> <p>5. Federacijama/Sportskim organizacija, prestaje im važiti licenca u slučajevima kada se utvrdi da su lica koja su nosioci funkcija u organima upravljanja, su i članovi subjekata koji se bave organizacijom sportskog klađenja najmanje tri godine.</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 12 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Necessary documentation for application</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Potrebna dokumentacija za apliciranje</p>
<p>1. Kërkesa për licencim në cilësinë e Federatës sportive bëhet me shkrim nga themeluesit e subjektit apo personi i autorizuar ligjërisht prej saj sipas Formularëve të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>2. Aplikimit për licencim të Federatës sportive duhet ti bashkangjiten dokumentet si vijon:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Certifikata apo kopja e noterizuar e regjistrimit në Departamentin përkatës për OJQ-të;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Certifikata apo kopja e noterizuar e numrit fiskal;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Statuti i i Federatës së bashku me aktet juridike të specifikuara në nenin 13 të këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. Dëshminë se të paktën tri (3) klube sportive që e përbëjnë një federatë sportive ushtrojnë aktivitet të pandërprerë sportiv së paku dy (2) vjetët e fundit përjashtuar rastet e ndërprerjeve për shkak të fuqisë madhore Vis Major;</p>	<p>1. The request for a license in the capacity of the Sports Federation shall be made in writing by the founders of the entity or the person legally authorized by it according to the Forms of this Administrative Instruction.</p> <p>2. The following documents must be attached to the application for a license by a Sports Federation:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Certificate or notarized copy of registration in the relevant Department for NGOs;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Certificate or notarized copy of fiscal number;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Status of the Federation together with the legal acts specified in article 13 of this Administrative Instruction;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. Evidence that at least three (3) sports clubs that make up a sports federation have exercised uninterrupted sports activity for at least the last two (2) years excluding cases of interruptions due to force majeure Vis Major;</p>	<p>1. Zahtev za licenciranje u svojstvu sportske federacije podnosi se u pisanoj formi od osnivača subjekta ili njihovog zakonski ovlašćenog lica prema obrascima ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>2. Uz aplikaciju za licenciranje Sportske federacije potrebno je priložiti sledeća dokumenta:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Sertifikat ili nostrifikovana kopija registracije u nadležnom Departamentu za NVO;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. Sertifikat ili nostrifikovana kopija fiskalnog broja;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. Statut Federacije zajedno sa pravnim aktima navedenim u članu 13. ovog Administrativnog uputstva;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.4. Dokaz da najmanje tri (3) sportska kluba koja čine sportsku federaciju obavljaju nesmetanu sportsku aktivnost najmanje dve (2) godine, isključujući slučajeve prekida usled više sile Vis Major;</p>

<p>2.5. Dëshminë që numri i caktuar i klubeve kanë anëtarësi në federatë dhe këtë anëtarësi federata dhe klubet arrijnë ta dëshmojnë duke prezantuar:</p> <p>2.5.1 Certifikatën apo kopje e noterizuar e regjistrimit;</p> <p>2.5.2 Certifikatën apo kopje e noterizuar e numrit fiskal;</p> <p>2.5.3. Aktin e themelimit;</p> <p>2.5.4. Statutin e organizatës;</p> <p>2.5.5. Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore;</p> <p>2.5.6.Përfaqësuesin e autorizuar të klubit;</p> <p>2.5.7.Vërtetimin që dëshmon se klubi është i regjistruar dhe zhvillon veprimtari në një komunë përkatëse në Republikën e Kosovës, i cili vërtetim lëshohet nga drejtoria përkatëse për sport;</p> <p>2.5.8.Dëshminë mbi numrin dhe të dhënat e anëtarëve për detyrat udhëheqëse të klubit;</p>	<p>2.5. Evidence that a certain number of clubs have membership in the federation and federations and clubs manage to prove this membership by presenting:</p> <p>2.5.1 Certificate or notarized copy of the registration;</p> <p>2.5.2 Certificate or notarized copy of fiscal number;</p> <p>2.5.3.Act of establishment;</p> <p>2.5.4. Statute of the organization;</p> <p>2.5.5.Certificate for payment of tax obligations;</p> <p>2.5.6.Authorized representative of the club;</p> <p>2.5.7.Certificate proving that the club is registered and operates in a relevant municipality in the Republic of Kosovo, which is issued by the relevant directorate for sports;</p> <p>2.5.8. Evidence on the number and data of members for the leading duties of the club;</p>	<p>2.5. Dokaz da određeni broj klubova ima članstvo u federaciju i to članstvo federacija i klubovi uspevaju da dokažu iznošenjem:</p> <p>2.5.1 Sertifikat ili nostrifikovana kopija registracije;</p> <p>2.5.2 Sertifikat ili nostrifikovana kopija fiskalnog broja;</p> <p>2.5.3. Akt o osnivanju;</p> <p>2.5.4. Statut organizacije;</p> <p>2.5.5. Potvrda o izmirenim poreskih obaveza;</p> <p>2.5.6. Ovlašćenog predstavnika kluba;</p> <p>2.5.7. Sertifikat koji dokazuje da je klub registrovan i da sprovodi aktivnosti u relevantnoj opštini u Republici Kosovo, koji sertifikat izdaje relevantna direkcija za sport;</p> <p>2.5.8. Dokazi o broju i podacima članova za rukovodeće dužnosti kluba;</p>
---	---	---

<p>2.5.9. Dëshminë mbi numrin e sportistëve të regjistruar në klub, e cila vërtetohet përmes ID-së së sportistit;</p> <p>2.5.10.Dëshminë mbi numrin e trajnerëve të klubit, e cila vërtetohet përmes ID-së.</p> <p>2.6 Listën e klubeve anëtare, sportistëve dhe kalendarin vjetor të garave;</p> <p>2.7. Dëshminë se Federata i ka të themeluara dhe plotësisht funksionale strukturat e qeverisjes të cilat përmbajnë vendime, procesverbale dhe/ose kontrata për:</p> <p>2.7.1. Kuvendin dhe bordin ekzekutiv;</p> <p>2.7.2. Sekretarin e përgjithshëm;</p> <p>2.7.3. Personelin për menaxhimin e financave dhe mbarëvajtjen e proceseve;</p> <p>2.7.4. Strukturat apo komisionet për administrimin e procedurave disiplinore dhe të mbrojtjes së të drejtave të sportistëve, klubeve dhe anëtarësisë së tyre duke</p>	<p>2.5.9. Evidence on the number of athletes registered in the club, which is verified through the ID of the athlete;</p> <p>2.5.10.Evidence on the number of coaches of the club, which is verified through ID.</p> <p>2.6 List of member clubs, athletes and annual competition calendar;</p> <p>2.7. Evidence that the Federation has established and fully functional its governance structures which contain decisions, minutes and/or contracts for:</p> <p>2.7.1. The Assembly and the executive board;</p> <p>2.7.2. The Secretary General;</p> <p>2.7.3. Personnel for financial management and process smoothness;</p> <p>2.7.4. Structures or commissions for the administration of disciplinary procedures and protection of the rights of athletes, clubs and their membership,</p>	<p>2.5.9. Uverenje o broju registrovanih sportista u klubu koji se overava putem ID kartice sportiste;</p> <p>2.5.10. Uverenje o broju trenera kluba koji se overava putem ID kartice.</p> <p>2.6 Spisak klubova članova, sportista i godišnji kalendar takmičenja;</p> <p>2.7. Dokazi da je Federacija uspostavila i ima potpuno funkcionalne strukture upravljanja koji sadrže odluke, zapisnike i/ili ugovore za:</p> <p>2.7.1. Skupštinu i izvršni bord;</p> <p>2.7.2. Generalnog sekretaru;</p> <p>2.7.3. Osoblje za finansijsko upravljanje i nesmetan tok procesa;</p> <p>2.7.4. Strukture ili komisije za administriranje disciplinskih postupaka i zaštitu prava sportista, klubova i njihovog članstva,</p>
---	--	---

